



Zyra e Kryetarit të Komunës

01

Nr. 030-2643/25

Datë 21.01.2025

DETYRAT E ZYRTARIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOMUNËN E KLINËS

Bazuar në nenin 39, të LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, i publikuar në GAZETËN ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 6 / 25 SHKURT 2019, PRISHTINË, zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave në Komunën e Klinës, me vendim të kryetarit të komunës, të datës 30.11.2022, më numër protokolli 01 Nr. 112-40699/22, ka këtë përshkrim të detyrave;

- 1.1 Informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave,
 - 1.2. Jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të këtij ligji,
 - 1.3 . Bashkëpunon me Agjencinë për Informim dhe Privatësi,
 - 1.4. Vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak, të referuar në nenin 36 të këtij ligji dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër,
2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysh si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit,
 3. Raporton të Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), si agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike,

4. Duhet të kujdesen, në çdo kohë, që të dhënat të mbrohen dhe përpunohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj,

5. Harton dokumente që përshkruajnë procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale,

6. Mbanë evidencë të saktë për numrin e kërkesave për këshill, opinion, ankesë si dhe të dhëna të tjera më rendësi.